



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

C-IV-15-1572

Parashtruesi i kërkesës: B e K në likuidim, Beograd, Republika e Serbisë, përfaqësuar nga av V K nga Beogradi Beograd.

Kundër

Palës kundërshtare: Agjencia Kosovare e Privatizimit rruga Dritan Hoxha, nr.55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, përmes gjyqtarin Asllan Krasniqi, me datën; 26.01.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

1. REFUZOHET si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga B e K me seli në Beograd, Republika e Serbisë. vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj vendimi me shkrim me numër PRZ075-0002, i datës 27.08.2015, i lëshuar nga AKP.
2. Secila palë i heqë shpenzimet e veta të procedurës.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Me datën 22.09.2015, pranë DHPGJS, është parashtruar kërkesë nga B e K Sh.a në falimentim me seli në B-Republika e Serbisë, kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit ndaj vendimit me shkrim me numër PRZ075-0002, të datës 27.08.2015, të lëshuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit me të cilin parashtruesit të kërkesës në procedurë të likuidimit i është refuzuar shuma prej 86,848.65 USD (Dollar Amerikan), në emër të detyrimeve kreditore nga NSH H (në likuidim).

Parashtruesi i kërkesës ndër të tjera ka theksuar se Autoriteti i Likuidimit ka nxjerrë vendimin me numër OUT/32438/15 të datës 27.08.2015, me të cilën kërkesën për kompensim të shumës prej 86,848.65 USD, në emër të detyrimit kontraktues të pa shlyer nga Ndërmarrja Shoqërore AC Hasi (në likuidim), e ka refuzuar si të pa bazuar.

Autoriteti i Likuidimit me vendimin në fjalë kërkesën e ka refuzuar mbi bazën e parashkrimit të kërkesës. Ka shtuar se Autoriteti i Likuidimit vendimin e cituar më lartë e ka marrë pa e konstatuar

mirë gjendjen faktike dhe duke e zbatuar në mënyrë të gabuar edhe të drejtën materiale dhe se vendimi është i pa ligjshëm dhe i pa drejtë. Në lidhje me konstatimin e gabuar të gjendjes faktike ka theksuar se konstatimi i Autoritetit të Likuidimit është i gabuar për faktin se pala kundërshtare ka theksuar parashtruesi i kërkesës ka ngritur padi pranë gjykatës jo kompetente, po ashtu ka theksuar se konkluzioni është hedhur poshtë për shkak të mungesës së kompetencës së gjykatës. Me datën 12.11.1990, B P e Jugosllavisë ka sjellë vendim me numër 276, mbi plotësimin e kushteve për hapjen e procedurës së falimentimit për Bankën e Kosovës SH.A. Ndërsa në bazë të vendimit me numër 2017/90 të datës 17.12.1990, Gjykata Ekonomike me seli në Beograd ka hapur procedurën e falimentimit për Bankën e Kosovës sh.a, me seli në Prishtinë, procedurë e cila është duke vazhduar edhe sot pranë kësaj gjykate. Rrjedhimisht rezulton se parashtruesi i kërkesës padinë në gjykatë e ka parashtruar me kohe pranë Gjykatës Ekonomike në Beograd. Me tutje ka theksuar se Gjykata e Ekonomike në Beograd nuk e ka hedhur poshtë padinë e parashtruar, mirëpo me aktvendimin XLIII-P-981&200, të datës 22.05.2000, e ka ndërprerë procedurën në çështjen e ngritur nga parashtruesi i kërkesës. Neni 390 i LMD-së parasheh se nëse padia hedhet poshtë për shkak të mungesës së kompetencës së gjykatës apo çfarëdo arsye tjetër që nuk ka të bëjë me thelbin e çështjes, kështu që kreditori ngritë përsëri padi në afatin prej tre muajve nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit mbi hedhjen poshtë të padisë dhe se konsiderohet se parashkrimi është ndërprerë, andaj i ka propozuar gjykatës që në kuptim të nenit 37.7 të Shtojcës së Ligjit me nr.04/L-034 parashtruesit të kërkesës brenda afatit ligjor të rishqyrtoj vendimin e Autoritetit të Likuidimit me numër OUT/32438/15.

Kësaj ankese parashtruesi si provë i ka bashkëngjitur:

- *Vendimin me numër ST 207/90, të datës 13.12.1990;*
- *Vendimin e Bankës popullore të Jugosllavisë;*
- *Vendimin e Gjykatës Ekonomike të Beogradit me numër XLIII-P-nr.981/2000;*
- *Vendimin e Gjykatës Ekonomike të Beogradit me numër ST207/90;*
- *Vendimin e Autoritetit të Likuidimit me numër PRZ075-0002;*

AKP-ja përmes përfaqësuesit të sajë ka paraqitur mbrojtjen ndaj kërkesës së parashtruar nga parashtruesi i kërkesës. Në mbrojtjen e parashtruar ndër të tjera ka theksuar se NSH H, ka hyrë në procedurën e likuidimit me datën 21.07.2014. Me datën 27.08.2014, parashtruesi i kërkesës ka parashtruar një kërkesë, me të cilën ka kërkuar kompensimin e detyrimeve kreditore në shumën prej 86,848.65 USD, Autoriteti i Likuidimit e ka shqyrtuar kërkesën e parashtruar nga parashtruesi i kërkesës në atë procedurë dhe me vendimin me numër PRZ075-0002, kërkesën e parashtruar nga parashtruesi i saj e ka refuzuar si të pa bazuar. Vendimin për refuzimin e kërkesës Autoriteti i Likuidimit ka marrë për faktin se ka konstatuar se kjo shumë e borxhit është e parashkruar. Andaj duke u bazuar në nenin 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit me numër 04/L-034, si dhe nenit 371 të LMD-së kërkesën për kompensimin detyrimeve kontraktuese e ka refuzuar.

Me tutje në mbrojtjen e parashtruar ka theksuar se Autoriteti i Likuidimit ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike e po ashtu drejtë i ka zbatuar edhe dispozitat ligjore. Në lidhje me themelin e kërkesës ka theksuar se objekt i kësaj procedure është ligjshmëria e vendimit të Autoritetit të Likuidimit dhe se parashtruesi i kërkesës nuk ka treguar me kërkesë se cila dispozitë e ligjit me nr. 04/L-034, nuk është respektuar nga ana e Autoritetit të Likuidimit. Me tutje ka theksuar se neni 390 i LMD-së ka parashikuar se nëse padia hudhet poshtë për shkak të mungesës së kompetencës së gjykatës apo çfarëdo arsye tjetër që nuk ka të bëjë me thelbin e çështjes, kështu që kreditori ngritë përsëri padi në afatin prej tre muajve nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit mbi hudhjen poshtë të padisë dhe se konsiderohet se parashkrimi është ndërprerë. Argumenti i paditësit se Gjykata Ekonomike në Beograd nuk është shpallur jo kompetente është i pa pranueshëm dhe se afati i parashkrimit ka filluar të rrjedh nga dita e marrjes së vendimit XLIII-P.nr. 232 të datës 22.05.2000. Pala paditëse ka qenë e detyruar që të ushtroj padi brenda afatit prej tre muajve nga marrja e vendimit të lartë cekur gjë të cilën nuk e ka bërë, andaj edhe kërkesa e pretenduar është e parashkruar.

Përfundimisht i ka propozuar gjykatës që kërkesën e parashtruar nga parashtruesi i kërkesës ta refuzoj si të pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit në pajtim në nenin 74.4 të Ligjit me numër 04/L-033.

Arsyetimi Ligjor

Në bazë të nenit 76 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-086 të DHPGJS në lidhje me nenin 399 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, Gjykata përcakton se faktet relevante të rastit janë të pakontestueshme dhe nxjerrë këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore. Pas shqyrtimit të provave të lëndës parashtrimeve dhe pretendimeve të palëve në procedurë gjykata ka ardhur në përfundimin se ankesa e parashtruar në këtë çështje është e pa bazuar.

Pas shqyrtimit të pretendimeve, parashtrimeve të palëve në procedurë dhe provave të lëndës gjykata ka gjetur se NSH Hasi, ka hyrë në procedurë të likuidimit me datën 21.07.2014. Parashtruesi i kërkesës me datën 27.08.2014, ka parashtruar një kërkesë pranë Autoritetit të Likuidimit, përmes të cilës ka kërkuar kompensimin e shumës prej 86,848.65 USD €, në emër të përmbushjes së detyrimit kontraktues nga NSH-ja në fjalë. Autoriteti i Likuidimit e ka shqyrtuar kërkesën e parashtruar dhe me vendimin me numër PRZ075-0002, të datës 27.08.2015, kërkesën e parashtruar nga pala ankuese në atë procedurë e ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar.

Objekt i shqyrtimit nga gjykata ishte kërkesa e parashtruar nga parashtruesi i kërkesës i cili ka kërkuar nga gjykata që ta ndryshoj vendimin e Autoritetit të Likuidimit dhe të detyrohet pala kundërshtarë që t'ia kompensoj edhe shumën prej 86,848.65 USD €. Parashtruesi i kërkesës e ka kundërshtuar pretendimin e palës kundërshtarë të dhënë në vendimin e vet se kjo kërkesë është e parashkruar, duke pretenduar se ka parashtruar padi pranë Gjykatës Ekonomike në Beograd.

Në anën tjetër pala kundërshtare në mbrojtjen e dhënë ka theksuar se në rastin konkret kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës andaj edhe Autoriteti i Likuidimit këtë kërkesë e ka refuzuar. Kjo për faktin se parashtruesi i kërkesës nuk i është drejtuar gjykatës në afatin e përcaktuar me dispozita e LMD-së. Nga shkresat e lëndës gjykata ka konstatuar se në rastin konkret kemi të bëjmë me kërkesë e cila daton që nga viti 1990. Me nenin 374.1 të LMD-së, së vitit 1978, është e përcaktuar se kërkesat reciproke të personave shoqëror juridikë nga kontrata në qarkullimin e mallrave e të shërbimeve si dhe kërkesat e kompensimit për shpenzimet e bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tre vjet. Ndërsa në paragrafin 2 të të njëjtit nen është e përcaktuar se parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo livrim malli, punë ose shërbim të kryer. Në rastin konkret pas shqyrtimit të provave të lëndës pretendimeve dhe parashtrimeve të palëve në procedurë gjykata ka ardhur në përfundimin se në rastin konkret kemi të bëjmë me kërkesë kreditore e cila daton nga viti 2000, ndërsa pala paditëse kërkesën për kompensim të kërkeses e ka parashtruar para Autoritetit të Likuidimit me datën 27.08.2014,që do të thotë se kjo kërkesë është bërë pas kalimit të afatit të përcaktuar me dispozita ligjore, rrjedhimisht edhe është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Po ashtu gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimin e paditësit i cili ka theksuar se parashkrimi është ndërprerë me parashtrimin e kërkersës pranë Gjykatës Ekonomike në Beograd në vitin 2000. Mirpo nga shkresat e lëndës rrjedh se kjo gjykatë është shpallur jo kompetente dhe se parashtruesi i kërkesës nuk ka parashktruar padi brenda afateve ligjore për parashkrimin e padisë pas shpalljes së gjykatës jo komptente për të vendosur në kërkesën e parashtruar nga parashtruesi. Përfundimisht gjykata ka ardhur në përfundimin se në rastin konkret i padituri drejtë ka vepruar kur ka zbatuar dispozitën ligjore të cituar me lartë dhe bazuar në vërtetimin e kësaj gjendje faktike dhe në pajtim me dispozitën e nenit 54.1 lidhur me nenin 74 të Ligjit nr. 06/L- 086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Shpenzimet Gjyqësore:

Në bazë të nenit 62 paragrafi 5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës,secila palë do ti heqë shpenzimet e veta.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës,brenda afatit prej 15 ditësh,llogaritur nga data e pranimit të këtij aktgjykimi.

Gjyqtari;
Asllan Krasniqi